VENDIM
Nr. 769, datë 16.9.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SË "FILANTOS", TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga rikonstruksioni i rrugës së "Filantos", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë "truall", me sipërfaqe 59 (pesëdhjetë e nëntë) m², me vlerë 2 110 017 (dy milionë e njëqind e dhjetëmijë e shtatëmbëdhjetë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 110 017 (dy milionë e njëqind e dhjetë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë "truall", prej 59 (pesëdhjetë e nëntë) m², për ndërtimin e rrugës,të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për ndërtimin e rrugës së Filantos.

NR.	EMËR MBIEMËR	Zona Kad.	NR. Pas.	Siperf. Pergj. m²	Siperf. Prekur m²	Çmimi per m²	Vlefta ne lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Eduard Fran Kaçi	8330	4/313	500	59	35763	2.110.017	Shkr.nr.prot.11286,dt.02.07.2013
						Shuma	2.110.017	